28891

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr 28891 i Vendimit

VENDIM

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me daten 23-1-2003 une gjyqtare e vetme e Gjykates se rrethit Tirane R. Pajojok, pasi studiova kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Isuf Mece,

KONSTATOVA SE:

I lartpermenduri se bashku me ortakun tjeter Artur Hitaj kane themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin «EUROBETON» SH.P.K. me kapital themeltar 100.000 leke, me seli ne Qendren Industriale, Gjirokaster, me kohezgjatje 50 vjete, me administratore te shoqerise Isuf Mece, me objekt te veprimtarise prodhimi dhe perpunimi I te gjitha materjaleve te ndertimit si dhe tregeti e pergjitheshme me shumice dhe pakice import-export.

Kerkesa e mesiperme eshte e bazuar ne ligj prandaj duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te L. Nr.7638 date 19.1.1992 «Per shoqerite tregetare» dhe L.Nr.7667 date 28.1.1993 «Per regjistrin tregetar...»

VENDOSA

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin «EUROBETON»SH.P.K. te ortakeve Isuf Mece dhe Artur Hitaj me kapital themeltar 100.000 leke, me seli ne Qendren Industriale, Gjirokaster, me kohezgjatje 50 vjete, me administratore Isuf Mece dhe me objekt te veprimtarise prodhimi dhe perpunimi I te gjitha materjaleve te ndertimit si dhe tregeti e pergjitheshme me shumice dhe pakice import-export./

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

GJYQTARE

z/j Reflek Pajojok

2003

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr 28891/1 i Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me daten 30/1/2004 une Z. Bungo gjyqtare e vetme e Gjykates se rrethit Tirane, pasi studiova kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise «EUROBETON» SH.P.K. Z. Isuf Mece per depozitimin e vendimit Nr.1 date 25.1.2004 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "EUROBETON" SH.P.K.., eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr.28891 date 23.1.2003 te Gjykates se shkalles se pare Tirane. Asambleja e shoqerise me vendimine saj me Nr. 1 date 25.1.2004 ka vendosur ndryshimin e N.4 te Statutit te shoqerise duke shtuar ne te nje paragraf me kete permbajtje " veprimtari ne fushen e ndertimeve civile dhe ekonomike, ndeertime rrugore, ndertime urra dhe vepra arti, ndertime hidraulike e hidroteknike, vepra te vecanta e punime speciale, punime restaurime, punime kaprentjere, impjante teknollogjike dhe te cecanta, punime montimi, punime sherbimi, punime topogjeodezike si dhe punime projektimi." Si dhe eshte shtuar nje paragraf ne N. 9 me kete permbajtje : "Drejtues teknik emerohet Z.Kristaq Rebi I biri I Gaqos I dl. 1960 I diplomuar 'inginjer per ndertime" me te cilin eshte lidhur kontrata e punes."

Per sa me lart kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit NR.7667 date 28.1.1993 « Per regjistrin tregetar...» dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 «Per shoqerite tregetare»

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregetar te vendimit Nr. 1 date 25.1.2004 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise dhe te dokumentave bashkengjitur kesaj kerkese.

Urdherohet zyra e regjistrimit qe te bej ndryshimet ne kolonen 4, 5 dhe ndarja te behet me vije te kuqe.

GJYQTARE
Reglete Bungo
Jan 2004

***REPUBLIKA E SHQIPERISE***
***GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE***
***NR.*** 28891/2 ***VENDIMIT***

***VENDIM***
***I GJYQTARIT TE VETEM***

Ne Tirane , sot me date 01./ 12/2005 , une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi *Isuf Meçe* , per depozitimin ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ,te vendimit nr. 01 date 12.06.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROBETON " SH.P.K.

***KONSTATOVA SE***

Shoqeria "EUROBETON " sh.p.k. eshte regjistruar ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr. 28891 date 23.01.2003 dhe aktualisht eshte e perbere nga ortaket Isuf Meçe dhe Artur Hitaj .

Nga analiza e vitit financiar 2004 rezulton te kete shtesa te kapitalit te shoqerise te cilat ortaket kane vendosur t'i kapitalizojne.

Ne keto rrethana me vendimin nr. 01 date 12.06.2005 asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur :

- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " EUROBETON " sh.p.k. ne natyre nga fitimi i trasheguar.
- Caktimin ekspert kontablet te autorizuar znj. Stoli Laze per te kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit themelatr te shoqerise per efekt te shtimit te ketij kapitali.
- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise
- Depozitimin e ketij vendimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa me siper , kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

***PER KETO ARSYE***

Bazuar ne ligjin nr. 7667 date 28.1.1993 dhe ne ligjin nr.7638 date 19.11. 1992:

***VENDOSA***

Pranimin e kerkeses.

- Depozitimin ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , te vendimit nr. 01 date 12.06.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise "EUROBETON " SH.P.K.

Te behen ndryshimet perkatese ne kolonen 4 dhe 5 te regjistrit tregetar .
Kunder vendimit lejohet ankim.

***GJYQTARE***

***REPUBLIKA E SHQIPERISE***
***GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE***
***NR.*** 28891/1/3 ***VENDIMIT***

## *VENDIM*
## *I GJYQTARIT TE VETEM*

Ne Tirane , sot me date 14 12/2005 , une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane , mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori **Isuf Meçe** per depozitimin e vendimit nr. 02 date 06.12.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise " EUROBETON " SH.P.K.

## KONSTATOVA SE

Me vendimin nr. 28891 date 23.01.2003 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare " EUROBETON" sh.p.k. me kapital themeltar 100 000 leke, me seli ne Gjirokaster dhe me ortake Isuf Meçe dhe Artur Hitaj , me administrator Z. Isuf Meçe, me kohezgajtje 50 vjet.
Me vendimin nr. 1 date 02.06.2005 eshte vendosur:

- Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar znj. Stoli Laze per shtesen e kapitalit.

Me vendimin nr. 2 date 06.12. 2005 eshte vendosur :

1. Miratimi i aktit te ekspertimit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " EUROBETON " sh.p.k. nga vlera 100 000 ( njeqind mije ) leke ne vleren 2 660 000 ( dy milione e gjashteqind e gjashtedhjete mije ) leke.
3. Depozitimin e ketij ndryshimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa me siper , kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Bazuar ne ligjin nr. 7667 date 28.1.1993 dhe ne ligjin nr.7638 date 19.11. 1992" Per regjistrin tregetar "

## <u>VENDOSA</u>

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin e vendimit nr. 2 date 06.12. 2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise " EUROBETON " sh.p.k..
- Te behen ndarjet me vije te kuqe ne regjistrin tregetar ne kolonat 4 dhe 5.
- Kunder vendimit lejohet ankim.

**GJYQTARE**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË
REGJISTRI I SHOQËRIVE TREGTARE

# URDHËR REGJISTRIMI

| | |
|---|---|
| **Kolona I** | Numri i Regjistrit Tregtar: 28891 |
| **Kolona II** | A. Emri i Shoqërisë: "Eurobeton" shpk<br>B. Selia: Qendra Industriale Gjirokastër<br>C. Objekti: Prodhim e grumbullim i te gjitha materialeve [illegible] [illegible]<br>D. Kapitali: 100.000 leke (njëqind mijë) leke në 2622 [illegible] Banka e Kursimeve Gjirokastër |
| **Kolona III** | A. Ortakët Isuf Meçe 65%<br>Artan Hoxha 35%<br>B. Administratorët: Isuf Meçe i biri i [illegible] [illegible] [illegible] 1967 [illegible] në [illegible] Gjirokastër |
| **Kolona IV** | Kohëzgjatja: 50 vjet. |
| **Kolona V** | Shënime mbi aktet e shoqërisë:<br>A. Data e Nënshkrimit: 18-01-2003<br>B. Data e regjistrimit: 23-01-2003<br>C. Statuti fletë: 4 fletë nr 101 Rep dt 18-01-2003<br>D. Akti i Themelimit fletë 2 fletë nr 100 Rep dt 18-01-2003 [illegible] |

*Shënime:*

GJYQTARE
[signature]

## AKTI I THEMELIMIT
## TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR «EUROBETON»SH.P.K

Ne Gjirokaster sot me daten 17.1.2003, ne:
1.Isuf Mece I biri I Tomorit I dl. 1967 banuers ne Lazarat, Gjirokaster dhe
2. Artur Hitaj I biri I Memos I dl. 1961 banues ne Lazarat, Gjirokaster
vendosem qe te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar sipas ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 «Per shoqerite tregetare» dhe ate me Nr. 7667 date 28.01.1993 «Per rregjistrin tregetar...» duke perpiluar kete akt themelimi me permbajtje si me poshte:

NENI 1

Te themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin «EUROBETON» SH.P.K. te ortakeve Isuf Mece dhe Artur Hitaj.

NENI 2

Selia e shoqerise eshte Qendra Industriale, Gjirokaster.
Shoqeria mund te hapi filiale dhe agjenci edhe ne vende te tjera te Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj me miratim te organeve kompetente.

NENI 3

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete 50 vjete. Ky afat fillon me daten e regjistrimit te shoqerise ne rregjistrin tregetar prane Gjykates se rrethit Tirane. Shoqeria ne cdo kohe dhe per cdo shkak , me vendim te Asamblese se ortakeve mund te shperndahet ose te prishet.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise dhe qellimi i saj do te jete: Prodhimi dhe perpunimi I te gjitha materjaleve te ndertimit si dhe tregeti e pergjitheshme me shumice dhe pakice import-export.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100.000 leke.Ky kapital ndahet ne 100 pjese,vlera nominale e cdo pjese eshte 1000 leke.
Ky kapital eshte depozituar ne Degen e Bankes Tirana Gjirokaster si me poshte:
1. Isuf Mece ka depozituar 65.000 leke ose 65 pjese ose 65%
2. Artur Hitaj ka depozituar 35.000 leke ose 35 pjese ose 35%

NENI 6

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e ortakeve.
Kompetencat e saj percaktohen ne Statutin e shoqerise.

NENI 7

Administratori i shoqerise caktohet Z.Isuf Mece I biri I Tomorit, i Dl.1967,banues ne Lazarat, Gjirokaster. Ky perfaqeson shoqerine para cdo organi dhe personi juridik ose fizik qofte privat ose shteteror.Me gjeresisht kompetencat e tij dhe menyra e ushtrimit te tyre percaktohen ne Statut.

NENI 8

Per arritjen e qellimit te saj shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes dhe specialiste te tjere duke lidhur me ta kontrata te vecanta pune sipas K.Punes ne fuqi.

NENI 9

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

NENI 10

Shoqeria mbaron me vendim te Asamblese se ortakeve ose me ligj.Me mbarimin e saj shoqeria vihet ne likujdim.

NENI 11

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakeve ne pamundesi te zgjidhjes se tyre me pajtim palet mund t'i drejtohen organeve gjyqesore shqiptare sipas legjislacionit shqiptar.

ORTAKET THEMELUES

ISUF MECE ARTUR HITAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER Nr/02 Rep.

V E R T E T I M

Ne Gjirokaster sot me daten 18.01 2003, para meje noteres Greta Kallojeri u paraqiten personalisht te quajturit Isuf Mece I bir4I I Tomorit I dl. 1967 banues ne Lazarat, Gjirokaster dhe Artur Hitaj I biri I Memos I dl. 1961, banues ne Lazarat, Gjirokaster te cilet deklaruan se nenshkrimi ne kete Akt themelimi eshte i tyre dhe eshte vene me vullnetin e tyre te lire.

NOTERE

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER
NOT. GRETA KALLOJERI
TEL 2270

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR «EUROBETON» SH.P.K

### NENI 1

Themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin «EUROBETON» SH.P.K. me ortake themelues
1.Isuf Mece i biri i Tomorit i datelindjes 1967 banues ne lagjen Lazarat, Gjirokaster dhe
2.Artur Hitaj I biri I Memos I dl. 1961 banues ne Lazarat, Gjirokaster.

### NENI 2

Selia e shoqerise do te jete Qendra Industriale, Gjirokaster.
Shoqeria mund te hapi filjale dhe agjensi edhe ne teritorin tjeter te Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj me miratimin e organeve kompetente.

### NENI 3

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte 50 vjete. Ky afat mund te zgjatet ose te shkurtohet me vendimin e Asamblese se shoqerise ne cdo kohe dhe per cdo shkak.

### NENI 4

Objekti dhe qellimi i shoqerise do te jete:
Prodhim dhe perpunim I te gjitha materjaleve te ndertimit si dhe tregeti e pergjitheshme me shumice dhe pakice import-export.

### NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.
Kapitali i mesiperm ndahet ne 100 pjese me nga 1000 leke secila
Kapitali themeltar eshte depozituar nga ortaket themelues ne raportet e meposhtme:
1. Isuf Mece ka depozituar 65.000 leke ose 65% ose 65 pjese.
2. Artur Hitaj ka depozituar 35.000 leke ose 35 % ose 35 pjese.
Kapitali themeltar mund te shtohet me vendim te Asamblese te ortakeve.
Cdo ndryshim i kapitalit themeltar pasqyrohet ne librin e shoqerise, ne te cilin shenohen emrat e ortakeve dhe kontributi i tyre.

NENI 6

Ortaku qe deshiron te shese pjesen e tij eshte i detyruar te njoftoje ortaket e tjere per ushtrimin e se drejtes se parablerjes. Ortaket jane te detyruar t'i pergjigjen ofertes se ortakut brenda 10 (dhjete) diteve nga data e marjes se komunikimit. Ne rast se shumica e ortakeve e blejne ate, atehere pjeset e blera i ndajne proporcionalisht.

Ne rast mosmarreveshjeje persa i takon vleres se pjeseve qe afrohen per shitje, atehere caktohet nje ekspert kontabel per vleresimin e tyre.

Ne rast se eshte e pamundur te caktohet nje ekspert brenda 10 diteve, emerimi i tij behet nga Gjykata.

Ne rast se ortaket qe ftohen per mbledhje tregohen indiferent ose nuk pranojne te ushtrojne te drejten e parablerjes, ortaku shites ka ta drejte te kerkoje persona te trete. Ne kete rast ndalohet shitja te me shume se nje person, me qellim qe te mos prishet ekuilibri i krijimit te shumices ne Asamblene e ortakeve.

Kalimi ose transferimi i pjeseve kryhet gjithmone me akt noterial.

Ne rast vdekjeje te ndonjerit prej ortakeve, trashegimtaret e tij ligjore, trashegojne te drejtat dhe pjesen e tij.

NENI 7

Shoqeria mban librin e ortakeve me te gjitha te dhenat si emri mbiemri , shtetesia , adresa e banimit ose e selise, pjeset e secilit ortak, kontributet ne kapitalin themeltar dhe ndryshimet e mundshme.

Konsiderohen ortak dhe mund te ushtrojne te drejtat e tyre para organeve te shoqerise, te gjithe ata persona qe jane rregjistruar ne librin e shoqerise.

NENI 8

Organet e shoqerise jane Asambleja e Pergjithshme dhe Administratori.

Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte i shoqerise dhe vendos per cdo ceshtje qe ka lidhje per shoqerine. Ajo vendos per dryshimin e Statutit, per emerimin dhe shkarkimin e Administratorit, per pranimin e ortakeve te rinj, per shtimin e kapitalit themeltar, per miratimin e bilancit vjetor, per ndarjen e fitimeve per kerkese-padi kundrejt perfaqesuesve te shoqerise, per shkrirjen e shoqerise dhe ne pergjithesi perben vullnetin e shoqerise pa asnje kufizim, brenda kushteve te percaktuara ne Statut dhe ligj.

Asambleja e Zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit dhe bile gjate tremujorit te pare nga data e perfundimit te vitit ekonomik. Thirrja per kete mbledhje behet me shkrim te pakten 15 (pesembedhjete)dite perpara.

Asambleja e Jashtezakonshme thirret nga Administratori ose nga ortaket qe perfaqesojne 10 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte e vlefshme ne rast se marrin pjese ortaket qe perfaqesojne me teper se gjysmen e kapitalit themeltar.

Vendimet e Asamblese miren me shumice votash te kapitalit qe marrin pjese ne mbledhje. Nje pjese e kapitalit i takon e drejta e nje vote.

Per ndryshimin e Statutit kerkohet miratimi i ortakeve qe perfaqesojne 3/4 pjese te kapitalit themeltar.

Ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme mbahet procesverbal i cili firmoset nga otaket qe marrin pjese ne mbledhje.

NENI 9

Shoqeria drejtohet gjate aktivitetit te saj nga Administratori.

Administatori caktohet Isuf Mece i biri i Tomorit i datelindjes 1967 banues ne Lazarat, Gjirokaster.

Ai drejton dhe administron ceshtjet e perditshme te shoqerise ne baze te ligjit, Statutit dhe udhezimeve te Asamblese se Pergjithshme, perfaqeson personin juridik dhe vepron ne emer e per llogari te tij per arritjen e qellimit te shoqerise. Ne pergjithesi kujdeset per te gjitha punet ne shoqeri. Ai perfaqeson shoqerine para organeve shteterore dhe private, personave fizike e juridik duke firmosur poshte emertimit te shoqerise. Administratorin mund t'a shkarkoje Asambleja e Pergjithshme. Administratori eshte i detyruar te kujdeset per te mbajtur librat e shoqerise, te perballoje dhe te likujdoje ne kohe detyrimet ndaj te treteve ose te vjeli kerkesat e shoqerise. Adminstatori perfaqeson shoqerine para gjithe organeve gjyqesore, komisioni shteteror apo organi, para cdo personi fizik apo juridik, terheq nga Bankat apo institucionet te tjera kredidhenese, cakton avokat te tjere autorizues, merr ne pune personelin per shoqerine dhe cakton rrogat dhe marredheniet e punes. Administratori mund te ushtroje kompetencat e tij vete ose nepermjet perfaqesuesit qe cakton vete si per nje, per disa ose per te gjitha kompetencat e tij si Adminstrator me miratim te Asamblese se ortakeve.

NENI 10

Ne fund te cdo viti financiar dhe nen kujdesin dhe pergjegjesine e Administratorit, kryhet perpilimi i te gjitha te dhenave te aktivit dhe pasivit me pershkrim te hollesishem. Ne baze te ketij pershkrimi nga Administratori perpilohet bilanci me analize te hollesishem te llogarise humbje-fitim.

Viti financiar fillon me 1 Janar te cdo viti kalendarik dhe perfundon ma 31 Dhjetor. Ky vit financiar fillon pas rregjistrimit te shoqerise ne zyren e Tatimeve dhe fillimit te aktivitetit.

Brenda tremujorit te pare pas perfundimit te vitit financiar perpilohet bilanci i cili duhet te miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Zakonshme e shoqerise.

Fitimet e realizuara ndahen midis ortakeve ne raport me kontributin e tyre ne kapitalin e shoqerise.

NENI 11

Shoqeria prishet ose me vendim te Asamblese se Pergjithshme ose ne baze te ligjit. Ne rast ~~prishje~~je te shoqerise do te ndiqet procedura e likujdimit te saj ne baze te dispozitave ligjore. Likujduesit caktohen nga Asambleja e Pergjithshme. Kur shoqeria prishet me vendim te Asamblese se Pergjithshme vendimi eshte i vlefshem kur miratohet nga shumica e kerkuar per ndryshimin e statutit.

Gjate periudhes qe shoqeria eshte ne likujdim ne emertimin e shoqerise shtohen fjalet «Ne likujdim».

NENI 12

Ne rast mosmarreveshjeje kur keto nuk zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen ne rruge gjyqesore nga gjykata shqiptare sipas legjislacionit shqiptar.

ORTAKET THEMELUES

ISUF MECE ARTUR HITAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER

Nr 104 Rep.

VERTETIM

Ne Gjirokaster sot me daten 18.01 2003, para meje noteres Greta Kalloj̈eri u paraqiten personalisht te quajturit Isuf Mece i biri i Tomorit i datelindjes 1967 banues ne Lazarat, Gjirokaster, dhe Artur Hitaj biri i Memos i datelindjes 1961 banues ne Lazarat ,Gjirokaster, persona te njojtur prej meje, te cilet deklaruan se perpilimi i ketij Statuti dhe nenshkrimi ne te eshte i tyre dhe shprehje e lire e vullnetit te tyre dhe une noterja pasi u binda per kete bej legalizimin sipas ligjit.




NOTERE
GRETA KALLOJERI

# KERKESE

Kerkuesi: Isuf Mece i biri i Tomorit i Dl.1967,banues ne Lazarat, Gjirokaster , administratore i shoqerise «EUROBETON» SH.P.K.

Objekti:Kerkohet regjistrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar «EUROBETON» SH.P.K. sipas ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 «Per

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

Ne ortaket themelues Isuf Mece dhe Artur Hitaj vendosem themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin «EUROBETON»SH.P.K.

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: prodhimi dhe perpunim I te gjitha materjaleve te ndertimit si dhe tregeti e pergjitheshme me shumice dhe pakice import-export. Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete per 50 vjete. Selia e shoqerise do te jete ne Qendren Industriale, Gjirokaster. Administratoret i shoqerise jane emeruar Isuf Mece I biri I Tomorit i Dl. 1967 banues ne Lazarat Gjirokaster. Kompetencat e tyre shprehen ne N.9 dhe 10 te Statutit te shoqerise. Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke nga te cilat 65.000 leke i perkasin Isuf Mece dhe 35.000 leke Artur Hitaj, .

Meqenese kerkesa e jone eshte e bazuar ne ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 «Per shoqerite tregetare»dhe ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 «Per regjistrimin regjistrn tregetar...»

## KERKOJME

Regjistrimin si person juridik te shoqerise «EUROBETON» SH.P.K.

KERKUESI
ISUF MECE

Te regjistrohet
Tirane me 23-01-2003

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE, GJIROKASTER

Nr. 88 Rep.

## VERTETIM

Ne Gjirokaster sot me daten 10.01. .2003 une noterja Greta Kallojeri vertetoj nenshkrimin e kerkuesit Isuf Mece I biri I Tomorit e Dl.1967, banues ne Lazarat, Gjirokaster.

DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER
NOT. GRETA KALLOJERI
TEL 2278

PULLE TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

Fazetar: depozituar prane BK Tirane date 15-01-2003 Nr 2622
Gjirokaster

**BANKA e TIRANES**
**TIRANA BANK**

2622

Branch: 0400 Dega GJIROKASTER
18 SHTATORI
GJIROKASTER
Tel: 00355-726-4125
SHQIPERI

MECI ISUF

LAZARAT
GJIROKASTER
ALBANIA

| | |
|---|---|
| Data | 15JAN03 |
| Tipi i Deal-it | Depoz.Escrow Deri ne 1 Muaj |
| Monedha | Lek |
| Refer.Llogarise | E1MB/G'TEE 4005 |
| Statusi | DEAL IRI/MODIFIK.SOT |

## K O N F I R M I M I I D E P O Z I T E S K O L A T E R A L

Konfirmojme depoziten e mbajtur si kolateral si me poshte

| | | |
|---|---|---|
| Shuma e depozites kolateral | | ALL 100,000.00 |
| Fillimi-Maturimi | 15JAN03-OPEN | |
| Perqindja e interesit | 0.0 | |
| Taksa e interesit% | 0.0 | |
| Ditet e inter./Baza | 0/365 | |
| Shuma totale interesit | | ALL 0.00 |
| Shuma totale e takses | | ALL 0.00 |
| Shuma neto e interesit | | ALL 0.00 |

Ne fillim

Ne maturim
0400 B/G'TEE4005
MECI ISUF PER RREGJISTRIM
E "EUROBETON" SHPK

TIRANA BANK S.A
GJIROKASTRA BRANCH

STEFAN KEKEZI MIRELA QURKU

Firma(t) e Autorizuar(a)

30031/1M/05-00

BANKA e TIRANES
TIRANA BANK

KODI FISKAL / FISCAL CODE : 3607408 NIPT / TAXE CODE : J 61924008 V

**BANK GUARANTEE. No 4005 dt 15.01.2003**

**Drejtuar: GJYKATA E RRETHIT TIRANE.**

Me kete dokument vertetojme se **Z. MECI ISUF** ka derdhur prane **"BANKES SE TIRANES" Sh.a., Dega Gjirokaster,** shumen prej **100.000 ( Njeqind mije leke vetem)** si ushtrim aktiviteti ne fushen e ndertimit tregeti e pergjithshme import-eksport.

Banka merr persiper te kaloje ne llogarine e perfituesit shumen qe i korrespondon kesaj Garancie Bankare ne rast se:

1.Perfundon afati I lishences ose para afatit me kerkese te subjektit dhe miratim nga Gjykata e Rrethit TIRANE.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne paraqitjen e dokumentit per zhbllokim nga Gjykata e Rrethit Tirane.

**BANKA E TIRANES SH.A**

**Stefan Kekezi** — **Branch Manager**

**Mirela Qurku** — **Operations Officer**

TIRANA BANK S.A

**TIRANA BANK, GJIROKASTER BRANCH**
**Rr "STUDENTI", Gjirokaster**

10551/30M/10-00

28891/3

S Blerina Anesa
12 DHJETOR 2005

**KERKESE**

**KERKUES :** Isuf Meçe, madhor, banues ne Gjirokaster, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

**OBJEKTI :** Depozitimi ne regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit nr. 02 date 06.12.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " EUROBETON " SH.P.K., ne baze te n. 243 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare"

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR**
**TIRANE**

Ju parashtroj se shoqeria " EUROBETON " sh.p.k.eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 28891 date 23.01.2003 , me kapital themeltar 100 000 leke, me seli ne Gjirokaster dhe me ortake Z. Isuf Meçe dhe Z. Arben Hitaj , me administrator Z. Arben Hitaj, me kohezgjatje 50 vjete.

Me vendimin nr. 2 date 06.12. 2005 eshte vendosur :

1. Miratimi i aktit te ekspertimit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze.
4. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " EUROBETON " sh.p.k. nga vlera 100 000 ( njeqind mije ) leke ne vleren 2 660 000 ( dy milione e gjashteqind e gjshtedhjete ) leke.
2. Depozitimin e ketij ndryshimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa me siper une administratori me kerkese drejtuar Gjykates kerkoj depozitimin e ketij vendimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates Tirane.

**KERKUESI**
**Isuf Meçe**

**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**NR.** 10884 **REPERTORI**

**VERTETIM**

Ne Tirane sot me date 06/12/2005, para meje noteres Silvana Merko, u paraqit personalisht **Z. Isuf Meçe,** banues ne Gjirokaster, identifkuar ne baze te ligjit, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperm e kane redaktuar jashte kesaj zyre noterie dhe me vullnetin e tij te lire e nenshkroi para meje noteres.

Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTER**

Silvana Merko

Të depozitohet dt 12-12-05
Vendimi i As Ortakeve Nr 2 dt 6.12.05
Raport Vlerësimi 6.12.05 + Vendim Nr 36 dt 10.1.00 ... vjeta

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA " EUROBETON " SH.P.K.**

**VENDIM**
**I ASAMBLESE SE ORTAKEVE**
**NR. 2 DATE 06.12.2005**

Ne mbledhjen e dates 06 dhjetor 2005, ne ortaket e shoqerise " EUROBETON " sh.p.k, pasi morem ne shqyrtim aktin e ekspertimit te eksertit kontabel te autorizuar znj. Stoli Laze per efekt te zmadhimit te kapitalit te shoqerise, ne perputhje me statutin dhe ligjin :

**VENDOSEM**

1. Te miratojme aktin e ekspertimit te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar znj. Stoli Laze.
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " EUROBETON " sh.p.k. nga vlera 100 000 ( njeqind mije ) leke ne vleren 2 660 000 ( dy milione e gjashteqind e gjashtedhjete mije) leke.
3. Depozitimin e ketij ndryshimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

**ORTAKET**

**Isuf Meçe Artur Hitaj**

**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**NR. 10894 REPERTORI**

**VERTETIM**

Ne Tirane sot me date 07/12/2005, para meje noteres Silvana Merko, u paraqiten personalisht **Isuf Meçe dhe Artur Hitaj** , banues ne Gjirokaster, te identifkuar ne baze te ligjit, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, te cilet me deklaruan se dokumentin e mesiperm e kane redaktuar jashte kesaj zyre noterie dhe me vullnetin e tyre te lire e nenshkruan para meje noteres.

Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**NOTER**
**SILVANA MERKO**

PULLE TAKSE
U LIKUJDUA

[redacted]

**KERKUESI** : Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " EUROBETON " SH.P.K., me administrator Z. Isuf Meçe madhor, banues ne Gjirokaster.

**O B J E K T I** : Depozitimi ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te vendimit nr. 01 date 12.06.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROBETON " SH.P.K. , ne baze te n. 243 te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregetare"

***PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE***

Ju parashtroj se shoqeria sh.p.k. eshte regjistruar ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr. 25077 date 29.01.2001 dhe aktualisht eshte e perbere nga ortaket Isuf Meçe dhe Artur Hitaj .

Nga analiza e vitit financiar 2004 rezulton te kete shtesa te kapitalit te shoqerise te cilat ortaket kane vendosur t'i kapitalizojne.

Ne keto rrethana me vendimin nr. 01 date 12.06.2005 asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur :

- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " EUROBETON " sh.p.k. ne natyre nga fitimi i trasheguar.
- Caktimin ekspert kontablet te autorizuar znj. Stoli Laze per te kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit themelatr te shoqerise per efekt te shtimit te ketij kapitali.
- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise
- Depozitimin e ketij vendimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

ADMINISTRATORI
Isuf Meçe

**VENDIM NR. 01**

**I asamblese se ortakeve te shoqerise**

"EUROBETON " **SH.P.K.**

Ne Tirane sot me dt. 12.06.2005, asambleja e ortakeve te shoqerise "EUROBETON " **SH.P.K.** e perbere nga dy ortaket Isuf Meçe dhe Artur Hitaj , qe perfaqesojne 100% te pjeseve te kapitalit te kesaj shoqerie:

***VEREN***

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EUROBETON " sh.p.k. eshte regjistruar ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane me vendimin nr. 28891 date 23.01.2003 dhe aktualisht eshte e perbere nga ortaket Isuf Meçe dhe Artur Hitaj.

Nga analiza e vitit financiar 2004 rezulton te kete shtesa te kapitalit te shoqerise te cilat ortaket kane vendosur t'i kapitalizojne.

Ne keto rrethana me vendimin nr. 01 date 12.06.2005 asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur :

- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise " EUROBETON " sh.p.k. ne natyre nga fitimi i trasheguar.
- Caktimin eksperf kontablet te autorizuar znj. Stoli Laze per te kryer dhe paraqitur raportin e vleresimit te gjendjes se kapitalit themelatr te shoqerise per efekt te shtimit te ketij kapitali.
- Pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise
- Depozitimin e ketij vendimi ne zyren e regjistrit tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Per sa me siper ortaket rane dakort dhe nenshkruan

Isuf Meçe Artur Hitaj

## KERKESE

KERKUESI: Isuf Mece I biri I Tomorit I dl. 1967, administrator i shoqerise «EUROBETON» SH.P.K. me seli ne Qendren Industriale, Gjirokaster.

OBJEKTI: Kerkohet depozitimi i vendimit Nr.1 date 25.1.2004 te Asamblese se jashtezakonshme te shoqerise sipas ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 «Per shoqerite tregetare»

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Z.Kryetar!

Shoqeria e jone eshte regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se rrethit Tirane me Nr.28891 date 23.1.2003 . Me vendimin Nr.1 date 25.1.2004 asambleja e jashtezakonshme e shoqerise ka vendosur ndryshimin e N.4 te Statutit si dhe te N. 9 te tij duke shtuar ne to nga nje paragraf ku behet fjale per shesen e objektit te veprimtarise edhe ne fushen e ndertimit si dhe emerimin e Drejtuesit Teknik per kete qellim.

Per sa me lart ne mbeshtetje te ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 «Per regjistrin tregeta...»dhe ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 «Per shoqerite tregetare.»

## KERKOJME

Depozitimin e vendimit me Nr.1 date 25.1.2004 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise «EUROBETON» SH.P.K.

KERKUESI
ISUF MECE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE GJROKASTER

Nr 144 Rep.

## VERTETIM

Ne Gjirokaster sot me daten 26.01.2004 une noterja Greta Kallojeri vertetoj nenshkrimin e kerkuesit Isuf Mece I biri I tomorit I dl. 1967, banues ne Gjirokaster, person I njojtur prej meje noteres.

NOTERE
GRETA KALLOJERI

100 LEKE
R.SHQIPERISE

146

# KONTRATE PUNE

E lidhur sot me daten 11.12.2003 deri me daten 11.12.2005 ndermjet punedhenesit SHOQ. " EURO BETON " shpk perfaqesuar administratori i saj nga zoti ISUF MECI, nga njera ane dhe KRISTAQ REBI me detyren e drejtuesit tek prane kesaj shoqerie , nga ana tjeter persa me poshte vijon:

20.01.07

I Punedhenesi merr persiper :

- Te siguroje pune brenda kesaj kontrate pune.
- Koha e kontrates do te jete dy vjet kalendarik, fillon me daten 11.12.2003 dhe mbaron me 11.12.2005.
- Si afat marrje ne prove do te jete nje muaj nga data e marjes.
- Paga baze mujore do te jete 10.500 dhjete mije e peseqind leke.
- Paga do te jepet nje here ne muaj.
- Sigurimet shoqerore do te paguhen rregullisht cdo muaj sipas legjislacionit perkates ne fuqi
- Punedhenesi mund te pushoje nga puna punemaresin kur nuk zbaton urdhrat e punedhenesit, nuk kryhen detyren, vjen me vonese ne pune, nuk zbaton rregullat e punes, kur mbush moshen per pension dhe eshte i paafte per te kryer detyren e ngarkuar.

II Punemarresi merr persiper :

- Te njohe dhe zbatoje rregulloren e brendeshme ne pune si dhe aktet ligjore dhe nenligjore qe normojne punen e tij.
- Te mos largohet nga puna pa lejen e punedhenesit
- Ka pergjegjesi per mallrat qe ka ne ngarkim.

III Mareveshja e punes zgjidhet

- Me marreveshje midis paleve
- Me kerkesen e punemaresit dhe pelqimin e punedhenesit.
- Me mbarimin e afatit te kesaj kontrate pune.

Per mosmarreveshjet qe lindin ne pamundesi per tu zgjidhur me mirekuptim, palet Mund ti drejtohen gjykates 5 dite brenda dates se marjes se njoftimit per largim.
Kjo kontrate lidhet me deshiren e paleve dhe nenshkruhet prej tyre.

P A L E T

PUNEDHENESI
Shoq. " EURO BETON " SHPK

Admin. Isuf MECI

PUNEMARRESI
Kristaq REBI

PULLE TARSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE
GJIROKASTER

Nr. 2377 rep.

V E R T E T I M

Ne Gjirokaster, sot me daten 11.12.2003, para meje noteres Greta Kallojeri, u paraqiten palet e kesaj kontrate pune, te njohur prej meje, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet kane nenshkruar jashte kesaj zyre dhe une bej legalizimin sipas ligjit.

PULLE TARSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

GJIROKASTER

# MINISTRIA E RREGULLIMIT TE TERRITORIT DHE TURIZMIT
## Komisioni i Dhënies së Liçensave Profesionale

# LIÇENSE
**Z.1733/2**



| | |
|---|---|
| **MBIEMRI** | **REBI** |
| **EMRI** | **KRISTAQ** |
| **ATESIA** | **GAQO** |
| **DATELINDJA** | **27.09.1960, Gjirokaster** |
| **VENDBANIMI** | **GJIROKASTER** |
| **DIPLLOMUAR, ME** | **1985** |
| **TITULLI** | **Ing. per ndertime civile – industriale - ura** |
| **Rregjistruar ne Rregjistrin themeltar qe nga data:** | **08.10.2002** |

## NE ZBATIM

| | | | |
|---|---|---|---|
| Kat. | 1 | | Germime dheu me punime eventuale murature e beton arme – Prishje dhe punime ne toke te germuar. |
| Kat. | 2 | a | Prodhim materiale inerte – gure. |
| | | c | Prodhim elemente betonie b/arme te zakonshem – pararendur – gure dekorative. |
| Kat. | 3 | a | Ndertime civile – industriale – turistike – bujqesore deri ne 5 kate. |
| | | b | Ndertime civile – industriale – turistike – bujqesore mbi 5 kate – Rikonstruksione. |
| | | c | Ndertim banese me skelet mbi 8 kate. |
| Kat. | 4 | a | Ndertim rruge kategoria V dhe IV. |
| Kat. | 6 | a | Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 metra. |
| Kat. | 8 | a | Ndertim ujesjelles – kanalizime – kanale e impiante vaditese. |
| Kat. | 9 | a | Siilose, kulla, kulla uji etj, b/arme – metalike. |
| Kat. | 11 | a | Punime karpentierie druri. |
| | | b | Punime karpentierie metalike. |

REPUBLIKA E SHQIPERISE DHOMA E NOTEREVE TIRANE Dt. 18.12.03
Nr. Rep.
VERTETIM
Vertetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin. Dokumenti u paraqit nga z.
Nr. Rasap.
NOTERE ... JETA BRISKU

**KRYETARI I KOMISIONIT**
**Agron DIBRA**

**Shenim:** Kjo licensë eshte e vlefshme deri me daten **17.07.2005**

PULLE TAKSE

SHOQERIA «EUROBETON» SH.P.K.
GJIROKASTER

VENDIM Nr.1 DATE 25.1.2004
I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE SHOQERISE
«EUROBETON» SH.P.K.

Asambleja e jashtezakonshme e shoqerise «EUROBETON» SH.P.K.e mbledhur sot me daten 25.1.2004 pasi mori ne shqyrtim ecurine e veprimtarise se shoqerise

KONSTATOI SE:

Shoqeria per shkak te rritjes se vellimit te punes se saj ka krijuar mundesi per zgjerimin e aktivitetit te saj edhe ne drejtim te fushes se ndertimit.
Ajo ka krijuar nje kapital te mjaftueshem per kete qellim si dhe ka edhe mundesite financiare dhe teknike per te shtrire aktivitetin edhe ne ndertim.
Si rrjedhim del e domosdoshme ndryshimi I dispozitave perkatese te Statutit qe bejne fjale per objektin e veprimtarise si dhe per caktimin e drejtuesit teknik.
Per kete arsye ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 «Per shoqerite tregetare», asambleja e shoqerise "EUROBETON" SH.P.K.

VENDOSI

1.Te ndryshoj N. 4 te Statutit te shoqerise duke shtuar ne nje paragraf me kete permbajtje: " veprimtari ne fushen e ndertimeve civile dhe ekonomike, ndertime rrugore, ndertim urra dhe vepra arti, ndertime hidraulike e hidroteknike, vepra te vecanta e punime speciale, punime restaurimi, punime kaprentjere, impjante teknollogjike dhe te vecanta, punime montimi, punime sherbimi, punime topogjeodezike si dhe punime projektimi."
2.Te ndryshoj N.9 e Statutit duke shtuar ne te nje paragraf me kete permbajtje: "Drejtues teknik emerohet Z.Kristaq Rebi I biri I Gaqos I dl. 1960 I diplomuar "inginjer per ndertime" me te cilen eshte lidhur edhe kontrata e punes."
Ky vendim te depozitohet nga administratori I shoqerise prane regjistrit tregetar Tirane se bashku me dokumentacionin pekates.
Ky vendim u more me unanimitetin e te gjithe ortakeve.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE
ISUF MECE ARTUR HITAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE GJIROKASTER N. 46 Rep.

VERTETIM

Ne Gjirokaster sot me daten 26.01.04 para meje noteres Greta Kallojeri u paraqiten personalisht te quajturit Isuf Mece dhe Artur Hitaj persona te njojtur prej meje noteres te cilet deklaruan se neneshkrimi ne kete vendim eshte shprehje e lire e vullnetit te tyre.

PULLE TAKSE 100 LEKE RE SHQIPERISE

## RAPORTI I
## EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

## MBI SHTIMIN E KAPITALIT TE NENSHKRUAR TE " EUROBETON" SH.P.K

Une e quajtura Stoli Laze Eksperte Kontabel e Autorizuar e ngarkuar nga Asambleja e Ortakeve" EUROBETON" Sh.p.k . me vendimin e saj Nr. 02 date14 . 06 .2005 si dhe emeruar nga Gjykata se Faktit Tirane me vedimin Nr 28891/2Date 02../.v.2005 per zmadhimin dhe vertetimin e shteses se kapitalit nepermjet fitimit te trasheguare dhe te vitit 2004 te shoqerise se mesiperme,paraqes raportin tim si me poshte vijon:

Shoqeria "EUROBETON"Sh.p.k eshte krijuar me vendim te Gjykates se rrethit Tirane Nr 28891 date 23.01.12003.
Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ne fushen artikujve te ndryshem e import eksportit .Nje hapsire te gjere veprimi ne fushen e tregetise se pergjithshme.
Ne momentin e themelimit kapitali i saj eshte 100 .000 leke e cila paraqitet ne bilanc sipas ligjit per kontabilitetin Nr.7661 date 19.01.1993 ne shumen 100.000 leke .
Gjate jetes se saj shoqeria ka ushtruar veprimtari kryesisht ne fushen e ndertimeve te ndryshme e sherbime dhe rezultatin e veprimtarise ushtrimore shoqeria nuk e ka shperndare per dividente.

Asambleja e Ortakeve ka vendosur te kapitalizoj fitimin e pashperndare dhe financimet e mesiperme te vitit 2004.

Per kryerjen e misionit te ngarkuar per zmadhimin dhe vertetimin e shteses se kapitalit te nenshkruar ,jemi bazuar:

-Ne ligjin nr.7638 dt.19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare"
-Ne ligjin nr.7661 date19.01.1993"Per Kontabilitetin"
-Ne bilancet e shoqerise deri ne fund te vitit 2004.
-Ne raportet e Auditimit te ketyre bilanceve
-Ne dokumentet ligjore te shoqerise (vendim gjykate,statut,kontrat themelimi).
-Ne vendimin e Asambles se Ortakeve nr. 02 date 14 .06 .2005per shtesen e kapitalit te shoqerise.

Ne fund te vitit ushtrimor 2004 shoqeria " EUROBETON" Sh.p.k ka te pasqyruara ne bilanc ne grupin e kapitaleve te veta vleren per 2.667.296.82 lek

.Kjo vlere perbehet nga kapitali i nenshkruar prej 100.000 leke nga rezerva ligjore e statutore per 10.000 leke dhe fitim i trasheguar dhe i vitit 2.557.296.82 lek dhe lehtesi tatimore ska lek .

Per sa mesiper Kapitali i nenshkruar i shoqerise mbi bazen e vendimit te Asmblese se Ortakeve dhe te vertetuar nga ana jone percaktojme:

1. Fitimi i pashperndare me rezervat eshte 2.567.296.82 lek

SHUMA 2.567.296.82lek

Llogarisim Kapitalin Themeltar si me poshte:

1. Kapitali i nenshkruar ne momentin e themelimit eshte 100.000lek
2. Shtese kapitali nga fitimi i trasheguar dhe rezervat 2.560.000lek

SHUMA 2.660.000lek

3. Diferenca prej 7.296.82 lek te kaloje rezerve ligjore per kapitalin.

Mbas perllogaritjeve te mesiperme rezulton:

| | |
|---|---|
| **A.Kapitali i nenshkruar i shoqerise** | **2.660.000 lek** |
| **B. Rezerva ligjore** | **7.296.82 lek** |

**Si perfundim: Vleresoj dhe vertetoj se kapitali i nenshkruar i shoqerise tregetare "EUROBETON" sh.p.k eshte 2.660.000(Dy milion e gjasteqindqind e gjashtedhjetemije ) leke.**

Gjirokaster 06. 12. 2009

Eksperte Kontabel e Autorizuar
STOLI LAZE

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
028
Stoli Laze
ALBANIA

# INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR TE SHQIPERISE
# (IEKA)

# LICENSE

*Kjo license i leshohet,* STOLI SHABAN LAZE

*per te ushtruar profesionin e* **EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR**.

*Kjo License leshohet ne baze te listes se hartuar nga Komisioni i Regjistrimit te E. K. A. dhe mban numrin:* 36 , *sipas kesaj liste.*

**PRESIDENTI**

(BAKI BERBERI)

Berberi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR
IEKA

*Leshuar me,* 10. 02. 2000